



DEGA LUSHNJE

Nr. 31 prot.

Lushnje, me 20.06.2019

KËRKESË

DREJTUAR:

KOMISIONEVE TE ZONAVE TE ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR.

LUSHNJE

BASHKISË LUSHNJE

KËRKUES:

PARTIA DEMOKRATIKE DEGA LUSHNJE.

LËNDA:

ANULLIMIN E PROÇESIT ZGJEDHOR NE REFERIM TE DEKRETIT TE PRESIDENTIT TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE ME NR. 11199, DATE 10.06.2019 PER SHFUQIZIMIN E DEKRETIT NR. 10928, DATE 05.11.2018 TE PRESIDENTIT TE REPUBLIKES "PER CAKTIMIN E DATES SE ZGJEDHJEVE PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE", DUKE ANULUAR DATEN 30 QERSHOR 2019, SI DITE TE ZHVILLIMIT TE ZGJEDHJEVE PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE.

Te nderuar Kryetare te KZAZ Lushnje, i nderuar Kryetar i Bashkise Lushnje, une Saimir Korreshi ne cilesinë e Kryetarit te Degës së Partisë Demokratike Lushnje dhe në emër të demokratëve të qytetit të Lushnjes kërkoj nga ana juaj anullimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore.


Te gjitha organet e ngarkuara për organizimin e zgjedhjeve të qeverisjes vendore kanë detyrimin kushtetues te zbatojnë dekretin e Presidentit te Republikës së Shqipërisë përsa i përket datës së zhvillimit të zgjedhjeve.

Presidenti i Republikes se Shqipërisë, me anë të Dekretit nr. 11199, date 10.06.2019 per shfuqizimin e dekretit nr. 10928, date 05.11.2018 te Presidentit te Republikes se Shqiperise "për caktimin e dates se zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", duke anuluar datën 30 Qershor 2019, si dite te zhvillimit te zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore, ka anuluar daten 30 qershor dhe nuk ka caktuar nje datë të re se kur këto zgjedhje do të mbahen.

Kujtojmë se, cdo vendim i cili është miratuar apo do të miratohet në KQZ apo në KZAZ në funksion të zgjedhjeve të 30 Qershor 2019 do të ishte i paligjshëm sepse me publikim e dekretit të mesipër në fletoren zyrtare KQZ apo KZAZ nuk ka asnjë bazë ligjore se ku të mbështesë vendimet e saj në lidhje me organizimin e zgjedhjeve vendore.

Kërkojmë gjithashtu lirim të ambienteve të zena nga KZAZ dhe kthimin e tyre në funksion normal publik pasi nuk ka me asnjë bazë ligjore që ato të mbahen të zena.




SAIMIR KORRESHI
Kryetar i Degës së PD